



UNMIK



IPVQ

---

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TË VETQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

## **UDHËZIM ADMINISTRATIV MA-Nr. 08/2005 PËR PIKAT DEZINFEKTUESE**

**Mars 2005  
PRISHTINË**

---



**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOHSHE TË VETQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTERIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
VLADA KOSOVA/ MINISTERSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në:

Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1 paragrafi 1.3 pika (d), neni 15 paragrafi 15.4 dhe neni 37 paragrafi 37.2 pika d të Ligjit për Veterinarinë Nr. 2004/21 të dt. 30 korrik 2004.

Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MA-Nr. 08/2005  
PËR PIKAT DEZINFEKTUESE**

**Neni 1**

Me këtë Udhëzim Administrativ me qëllim të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektuese të Listës "A" dhe "B", caktohen pikat dezinfektuese - preventive në vendkalimet kufitare - administrative.

**Neni 2**

2.1 Pikat dezinfektuese - preventive, për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ janë:

1. Vërmica,
2. Kulla Pass - Pejë
3. Hani i Elezit,
4. Dheu i Bardhë - Porta 5
5. Merdare - Porta 3,
6. Gllloboqica,
7. Porta I - Leposaviq - Jerinje,
8. Zubin Potoku - Porta 31,
9. Qafa e Prushit,
10. Keqekollë dhe
11. Aeroporti dhe Hekurudha sipas nevojë.

2.2 Në rast të paraqitjes së nevojës për aktivizimin e pikave të reja dezinfektuese - preventive, Kryeshefi i Agjencionit Veterinar dhe Ushqimit të Kosovës mund të bëjë këtë me vendim të posaçëm.

### **Neni 3**

Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve infektuese në Kosovë, të gjitha automjetet që hyjnë në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe automjetet e UNMIK-ut - KFOR-it, duhet të kalojnë përmes pikave dezinfektuese të cilat janë me dezinfektant e që janë të vendosura në vendkalimet kufitare të cekura në nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

### **Neni 4**

4.1 Vozitësit e automjeteve që u nënshtrohen dezinfektimit nëpër pika dezinfektuese - preventive janë të obliguar të paguajnë tarifë për dezinfektim dhe atë: autobusët dhe kamionët 5€.

4.2 Automjetet tjera si: kombibusët, automjetet e udhëtarëve, automjetet e KFOR-it - UNMIK-ut, Organizatave Ndërkombëtare, atyre humanitare, qeveritare dhe diplomatike lirohen nga tarifa, mirëpo janë të obliguara që të bëjnë dezinfektimin në për pikat dezinfektuese.

### **Neni 5**

Agjencioni Veterinar dhe Ushqimit të Kosovës - obligohet që ti mbulojnë të gjitha pikat dezinfektuese - preventive me numër të mjaftueshëm të zyrtarëve të AVUK-ës në 24 orë (tri turne) të cilët përveç pagave mujore gëzojnë të drejtën në kompensimin shtesë nga baza e rrezikshmërisë në punë.

### **Neni 6**

Të hyrat e mbledhura nga pikat dezinfektuese derdhen në buxhetin e Kosovës.

### **Neni 7**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara në nenin 45 paragrafi 45.2 të Ligjit për Veterinarinë

### **Neni 8**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 23 /03. /2005

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Zëvendësministri,

---

/ Tomë Hajdaraj /